



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Prishtinë, 10 korrik 2025
Kodi i ZRRE-së: V_2763_2025

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke marrë parasysh:

- Dispozitat e Nenit 9 paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, Nenit 15, Nenit 26, paragrafit 1, nënparagrafit 1.2, Nenit 28, paragrafit 2, nënparagrafit 2.11, Nenit 30 dhe Nenit 32 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 32 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085);
- Dispozitat e Nenit 3 paragrafi 1 nënparagrafi 1.11, Nenin 4, Nenin 6, Nenin 7, Nenin 8 dhe Nenin 15 të Rregullës Nr. 07/2017 për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë;
- Nenin 127 të Ligjit Nr. 08/L-262, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që përmbajnë Procedura të Veçanta Administrative dhe Harmonizimin e tyre me Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative faza e dytë,
- Aplikacionin me dokumentet e bashkëngjitura, të datës **23.05.2025** për licencim të aktivitetit të furnizimit me shumicë (tregtim) të energjisë elektrike, të bërë nga ndërmarrja **Energy Kosova V.B. SH.P.K. Rr. Hysë Selimi Nr.18, Pejë Republika e Kosovës.**

në seancën e mbajtur me datë 10 korrik 2025 nxori këtë:

VENDIM

- I. I LËSHOHET LICENCA për Furnizim me shumicë (tregtim) të Energjisë Elektrike ndërmarrjes Energy Kosova V.B. SH.P.K., me adresë: Rr. Hysë Selimi, Pejë, me numër Licence ZRRE/Li_102/25, për periudhën kohore prej pesë (5) vitesh dhe do vlejë nga 10.07.2025 deri 09.07.2030.**
- II. Obligohet ndërmarrja të sjell në Rregullator çdo dokument të lëshuar nga institucione të ndryshme për Energy Kosova V.B. SH.P.K. të cilët mund të kenë ndikim në validitetin dhe periudhën e vlefshmërisë së licencës së lëshuar, si dhe çdo dokument i cili mund të ndryshoj nga ai i sjellë gjatë aplikimit për marrje të licencës.**
- III. Obligohet pala të bëjë pagesën e taksës vjetore të licencimit për import të energjisë, në pajtim me Rregullën për Taksat (Rregulla ZRRE/Nr.01/2020) dhe Vendimin e Bordit të Rregullatorit V_1498_2022 të datës 16.02.2022.**

Arsyetim



- Zyra e Rregullatorit për Energji (Rregullatori) me datë **23.05.2025** ka pranuar nga përfaqësues të ndërmarrjes **Energy Kosova V.B. SH.P.K.** Aplikacionin me dëshmitë përkatëse për Licencim të aktivitetit të **Furnizimit me shumicë (tregtimit) të energjisë elektrike** në Kosovë.
- Rregullatori ka vlerësuar se ndërmarrja në fjalë ka vepruar sipas udhëzimeve të Rregullatorit dhe kërkesave të parapara në Aplikacionin për Licencim të Aktivitetit të furnizimit me shumicë (tregtimit) të energji elektrike në Kosovë dhe legjislacionit tjetër në fuqi.
- Pala ka bërë pagesën e taksës fillestare në shumë prej njëmijë euro (1,000 €), në pajtim me Rregullën për Taksat (Rregulla ZRRE/Nr.01/2020) dhe Vendimin e Bordit të Rregullatorit V_1498_2022 të datës 16.02.2022.
- Sipas Nenit 6 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, ndërmarrja **Energy Kosova V.B. SH.P.K.** me datë **09.06.2025** ka njoftuar përmes gazetës (portaleve në mungesë të gazetave) palët e interesit se ka dorëzuar në Rregullator Aplikacionin për licencim të aktivitetit të furnizimit me shumicë (tregtimit) të energjisë elektrike dhe se aplikacioni është në fazën finale për marrje të licencës. Palët e interesit kanë pasur të drejtë të kundërshtojnë aplikacionin, nëse dëshmojnë për ndonjë parregullsi të tij brenda tetë (8) ditësh kalendarike, nga data kur njoftimi është publikuar në gazetë (portal). Rregullatori nuk ka pranuar ndonjë kundërshtim të bërë nga palët e interesit, për këtë aplikacion.
- Pas dorëzimit të dokumenteve të kërkuara, pagesës së taksës dhe publikimit të njoftimit në gazeta ditore (portale), rregullatori ka nxjerr këtë vendim brenda afateve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
- Licenca e lëshuar sipas këtij Vendimi do të vazhdojë të jetë e vlefshme për periudhën sipas pikës I të dispozitivit të këtij Vendimi, me mundësi vazhdimi, nëse i licencuari aplikon për vazhdim licence **jo më vonë se gjashtë (6) muaj** para skadimit të afatit të licencës në pajtim me Nenin 32 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë dhe legjislacionin tjetër në fuqi.
- Rregullatori pas vlerësimit të aplikacionit dhe dëshmimeve të tjera të bashkëngjitura aplikacionit të ndërmarrjes **Energy Kosova V.B. SH.P.K.** dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

IV. Vendimi nxirret në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

V. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të Rregullatorit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të Rregullatorit, cilado që ndodh e fundit.

Adresa: Rr. Bekim Fehmiu (ish Ndërtesa e Fazitës) Kati 2, 10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: 038 247 615 lok. 101, Fax: 038 247 620, E-mail: info@ero-ks.org, web: www.ero-ks.org



Ky **vendim** dhe **Licenca Nr ZRRE/Li_102/25**, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi i dërgohet:

- Ndërmarrjes **Energy Kosova V.B. SH.P.K.** dhe
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji

Bordi i Rregullatorit:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Lutfije Dervishi, anëtare

Gani Buçaj, anëtar

Arta Isufi, anëtare

Adnan Preniqi, anëtar